



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakt i raportit përfundimtar të revizionit

### Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Konvikti Shtetëror i Studentëve "Tome Stefanovski - Seniç" - Shkup (llogaria buxhetore nga aktivitetet vetëfinanciare).

### Lënda e revizionit:

Revizion i pasqyrave financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë

### Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindja a janë pasqyrat financiare të liruara nga gabime në të gjitha aspektet materiale

### Gjendjet kyçe të identifikuara:

- të arkëtueshme të paregjistruara nga studentët në regjistrat e kontabilitetit;
- regjistri jo i plotë i arkëtimeve për TVSH të mbipaguar;
- parregullsi në pagimin e tarifave të anëtarëve të Bordit Drejtues;
- mosrespektimi i vazhdueshëm i dispozitave të Ligjit për Furnizime Publike.

### Opinion i dhënë \*:

Shprehet mendim i pafavorshëm për vërtetësinë dhe objektivitetin e pasqyrave financiare dhe rezultatin e aktiviteteve financiare, si dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me legjislacionin përkatës, udhëzimet dhe politikat e përcaktuara për vitin 2019.

### Rekomandimet kyçe:

- regjistrimi i rregullt dhe në kohë i arkëtimeve të llogaritura dhe të mbledhura nga studentët;
- në bashkëpunim me DAP-in rikthimi i arkëtimeve në emër të TVSH-së;
- pagesa e kuotës së anëtarësisë dhe puna në Bordin Drejtues të bëhet në përputhje me aktet e brendshme të miratuara;
- zbatim i plotë i dispozitave ligjore gjatë procesit për furnizime publike.

### Dobësitë kyçe të sistemit:

/

### Vërejtjet e marra mbi draft Raportin:

Nga ana e drejtorit të mëparshëm të Konviktit janë pranuar vërejtjet mbi draft raportin e RASH numër 16-382 / 7 të datës 25.03.2021.

Nga ana e personi përgjegjës të Konviktit janë pranuar vërejtje mbi draft raportin e RASH me numër 16-382 / 8 të datës 01.04.2021.

### Përgjigja ndaj vërejtjeve të marra:

Vërejtjet u shqyrtuan dhe u konkludua se një vërejtje paraqet informim për gjendjen e konstatuar, ndërsa vërejtjet tjera nuk pranohen për shkak të mungesës së provave shtesë për të ndryshuar gjendjen e krijuar.

\*  pozitive,  me rezervë,  i pafavorshëm,  i përmbajtur